

# **Udherrefyesi te Praktikes Klinike (UPK) Leishmanioza viscerale**

**Data e publikimit: Dhjetor 2010**

**Data e rishikimit: Sipas nevojës**

## Grupi i punes:

Eli Foto	kryetar	QSUT
Hamide Bregu	sekretar	QSUT
Raida Petrela	anetar	QSUT
Esmeralda Bregu	anetar	QKCSA
Brikena Dedo	anetar	MSH
Rustem Prenika	anetar	ISKSH

## Permbajtja

1. Definicion.....	2
2. Etiologjia.....	2
3. Patogjeneza.....	3
4. Manifestimet klinike.....	4
5. Diagnoza.....	4
6. Diagnoza diferenciale.....	5
7. Trajtimi.....	6
8. Trajtimi i rasteve rezistente.....	14
9. Rekomandime.....	
10. LV dhe kujdesi paresor.....	21
11. LV dhe mjeku.....	22
12. Diagnoza laboratorike e LV.....	26
13. LV dhe shendeti publik.....	27
14. LV dhe ministria e shendetesise.....	29
15. LV dhe kerkimet shkencore.....	31
16. Prespektivat e trajtimeve te se ardhmes.....	33
17. Akronimet.....	35
18. Foto.....	36
19. Algoritmi i vendimeve.....	42
20. Literatura.....	45

## Akronimet

<b>LV</b>	<b>Leshmania Viscerale</b>
<b>ALT</b>	<b>alanine transaminaza</b>
<b>AST</b>	<b>aspartat transaminaza</b>
<b>ALP</b>	<b>fosfataza alkaline</b>
<b>DAT</b>	<b>testi i aglutinimit direct</b>
<b>DTD</b>	<b>Diametri Tele Diastolik</b>
<b>DTS</b>	<b>Diametri Tele Sistolik</b>
<b>E</b>	<b>eritrocite</b>
<b>EKG</b>	<b>elektrokardiograme</b>
<b>ELISA</b>	<b>Enzyme Linke ImmuosorbentAssay</b>
<b>FDA</b>	<b>U.S Food and Drug Administration</b>
<b>Fk</b>	<b>Frekuenca kardiake</b>
<b>Fr</b>	<b>Frekuenca respiratore</b>
<b>Hg</b>	<b>Hemoglobina</b>
<b>IFAT</b>	<b>Indirect Immunofluorescent Antibody Test</b>
<b>OBSH</b>	<b>Organizata Boterore e Shendetesise</b>
<b>PCR</b>	<b>reaksioni I ndryshimit te polimerazes</b>
<b>PCV</b>	<b>Packed Cell Volume</b>
<b>PKDL</b>	<b>Leishmanioza Kutane Post Kala-azariane</b>
<b>TA</b>	<b>Tensioni Arterial</b>
<b>WBC</b>	<b>Leukocite</b>
<b>Wastern Blots</b>	<b>Hibridizimi ADN-ADN</b>
<b>cm</b>	<b>centimeter</b>
<b>g</b>	<b>gram</b>
<b>mg</b>	<b>milligram</b>

<b>ml</b>	<b>mililiter</b>
<b>mm</b>	<b>milimeter</b>
<b>kg</b>	<b>kilogram</b>
<b>sed</b>	<b>sedimenti</b>

**Falenderime:**

Falenderoj MSH, QKCSA – ISH dhe ISKsH per ndihmen dhe suportin e dhene.

## Perkufizimi i termave te perpilimit

**Leishmaniozat** përbëjnë një grup sëmundjesh parazitare zooantroponotike të shkaktuara nga protozoar flagjellar intra qelizor të gjinisë “leishmania” të cilët i transmetohen njeriut nëpërmjet pickimit nga flebotomet sandflies të infektuara tek rezervuari. Format e ndryshme të sëmundjes me të cilat ajo shfaqet janë të përcaktuara nga:

- a) shkaktari
- b) epidemiologjia
- c) transmetimi
- d) shpërndarja gjeografike.

## Qellimet e UDHERREFYESIT:

1. Krijimi i nje udherrefyesi mbi kontrollin e LV, ekzaminimin fizik, diagnostikimin, punen e shendetit publik dhe kerkimet shkencore.
2. Udherrefyesi te jete i pershtatshem per tu perdorur ne vendet endemike, duke e lehtesuar perdorimin e tij nepermjet perkthimit ne gjuhete perkatese.

Lidhur me semundjet infektive dhe vecanerisht me LV, ka shume studime por dy karakteristikat e ketij studimi jane:

1. Gjate studimit iu dha pergjigje shume pyetjeve specifike qe konfrontonin ne nivele te ndryshme kontrollin e LV.
2. Punimi eshte i ndare ne pjese te cilat i korrespondojne roleve te secilit specialitet te perfshire ne kontrollin e LV. Secila pjese eshte lehtesisht e perdorshme dhe e pavarur nga pjeset e tjera.

## Objektivi

Te standartizohet mjekimi per formen viscerale te semundjes LV per te gjitha spitalet sekondare dhe qendrat spitalore terciare ne menyre qe te unifikohet mjekimi ne te gjithe Shqiperine

# Perdoruesit

Perdoruesit e udherrefyeshit janë mjeket e shërbimit të sëmundjeve infektive në QSUT dhe spitalet e rretheve. Subjekti që do të marrë medikamentet për LV janë fëmijet e moshës 0-14 vjeç të hospitalizuar me diagnozën Leishmanioze Viscerale si dhe mjeket e familjes.

## DEFINICIONI

Leishmaniozat përbëjnë një grup sëmundjesh parazitare zooantroponotike të shkaktuara nga protozoar flagjellar intra qelizor të gjinisë "leishmania" të cilët i transmetohen njeriut nëpërmjet pickimit nga flebotomet sandflies të infektuara tek rezervuari. Format e ndryshme të sëmundjes me të cilat ajo shfaqet janë të përcaktuara nga:

- a) shkaktari
- b) epidemiologjia
- c) transmetimi
- d) shpërndarja gjeografike.

Rezervuari i parazitit është kryesisht qeni i shtëpisë dhe kafshët e tjera të egra, si çakalli dhe dhelpira. Rolin e vektorit e luajnë insektet flebotomus prej të cilave në vendin tonë janë identifikuar Ph.Papagasi, Ph.sergenti, Ph.Sergentomya, Ph.Tobbias etj.

Leishmanioza është një zoonozë e cila vlerësohet se prek 10-50 milion njerëz në zonat endemike tropikale dhe subtropikale në të gjitha kontinentet me përjashtim të Australisë dhe Antarktidës. Incidenca vjetore (anuale) vlerësohet të jetë 1-1.5 milion njerëz raste për leishmaniozën kutane dhe 500 000 raste për formën viscerale me 90% të tyre të ndodhura në Bangladesh, Indi, Nepal dhe Sudan. Në regjionin mesdhetar 1,5-9% e pacientëve me AIDS zhvillojnë Leishmaniozën viscerale dhe 25%-70 % e adultëve me VL janë të lidhura me infeksionin e HIV, pasi LV është duke u bërë një infeksion oportunist i rëndësishëm në ato zona ku ajo bashkëjeton me infeksionin e HIV-it.

Tre format kryesore të sëmundjes janë:

- a) Leishmanioza viscerale
- b) Leishmanioza kutane
- c) Muko-kutane (espundia)

## Leishmanioza viscerale

Është quajtur ndryshe edhe kala-azar, ethja e zeze.

## Etiologjia

Forma viscerale e sëmundjes shkaktohet nga keto specie të Leishmanies:

L. donovani - kompleks përgjegjëse për leishmaniozën viscerale në Indi, Afrikën Lindore.

L. Chagasi - përgjegjëse për leishmaniozën viscerale në Amerikën Jugore.

L.infantum - përgjegjëse për leishmaniozën viscerale në pellgun e mesdheut, duke përfshirë edhe Shqipërinë.

## **Morfologjia dhe cikli jetësor**

Paraziti ekziston në dy forma morfologjike kryesore të quajtura “amastigot” dhe “promastigot”. Amastigotët janë ovoidë, të palëvizshëm dhe intraqelizorë. Promastigotët janë të zgjatur, të lëvizshëm me zhvillim jashtë-qelizor. Mënyra e qartë e transformimit të parazitit, dhe kapja nga makrofagët e lëkurës është e paqartë, por në përgjithësi mendohet që kapja shfaqet shpejt pas inokulimit dhe që transformimi nga forma promastigotë në atë amastigotë ndodh brenda qelizës strehuese. Ky proces, nga studimet e bëra invitro, mund të kompletohet brenda 24 orëve. Pastaj, paraziti mbetet në formën e amastigotit për zgjatjen e fazës normale të ciklit jetësor. Amastigotët rriten dhe ndahen brenda qelizave strehuese të tyre, herë pas here duke shpërthyer jashtë dhe duke infektuar makrofagë të rinj. Në LV mund të ketë një lezion fillestar të lëkurës, por simptomat e sëmundjes vihen re më vonë me fillimin e temperaturës dhe simptomave klinike të tjera që shoqërohen me infeksionin e organeve.

## **Patogjeneza e sëmundjes**

Mekanizmat imunë qelizorë përcaktojnë ndjeshmerinë ose rezistencën e leishmaniozës. Rezistenca është e nxitur nga ekspansioni i popullimeve të qelizave T-helper (Th 1) me prodhimin e CD4+, e interferonit gamma, gjë që çon në aktivizimin e makrofagëve dhe në vrasjen e parazitit. Interleukina 12 (IL-12) luan një rol qendror në zhvillimin e përgjigjes mbrojtëse të Th1. Ndjeshmëria është e lidhur me ekspansionin e IL-4 që çon në prodhimin e qelizave Th2 dhe prodhimin e IL-10 dhe transformimin e faktorit të rritjes Beta, të cilët janë inhibitorë të fuqishëm të aktivizimit makrofagealë. Qelizat T të nëntipit CD4+ duket se luajnë një rol të veçantë në kontrollin e infeksionit nga leishmania. Në vendin pickimit nga transmetuesi mund të formohet një lezion dermal i vogël sa një kokërr bizele, parazitët fillimisht të lokalizuar nga makrofagët dermalë, diseminoohen brenda makrofagëve në shpretkë, mëlçi, palcë kockore dhe limfonodula. N.q.s. infeksioni nuk eliminohet nga përgjigja imunitare qelizore e bujtësit, atëherë ai bëhet klinikisht evident. Pra, shihet qartë se rruga që zgjedh për t'u përgjigjur ndaj infeksionit individit është kritike dhe deçizive për dekursin e sëmundjes. Kërkime të mëtejshme kanë përcaktuar se qelizat CD4+ e vendosin atë.


Pacientët që zhvillojnë leishmaniozën viscerale, tregojnë një përgjigje imunitare qelizore minimale ndaj infeksionit specifik, e cila rekuerohet pas një terapie të suksesshme.

Në zonat endemike, infeksioni subklinik i kaluar, mund të identifikohet nëpërmjet testit të hipersensibilitetit të lëkurës ndaj antigjenëve leishmanialë (Montenegro skin test).

Faktorët e lidhur me bujtësin (prejardhja gjenetike, faktorët nutricionalë, sëmundjet shoqëruese), faktorët e lidhur me parazitin (virulenca, madhësia e papulës në vendin e inokulimit) dhe faktorët e lidhur me vektorin (genotipi i vektorit), duket se kontribuojnë në shfaqjen e infeksionit në dy forma: si infeksioni subklinik ose si shfaqje e formës aktive të sëmundjes.

Në zonat endemike prevalenca e testit pozitiv të lëkurës, rritet me moshën dhe incidenca e sëmundjes së shfaqur klinikisht ulet me moshën. Kjo tregon se imuniteti në popullatë fitohet me kalimin e kohës. Individet me sëmundje aktive të kaluar, apo ato të cilët kanë kaluar një infeksion subklinik, janë zakonisht të imunizuar ndaj një infeksioni klinik të mëpasëm.





## Ndryshimet patologjike në leishmaniozën viscerele

Lezionet themelore patologjike të sëmundjes janë rezultat i hiperplazisë së qelizave retikuloendoteliale, sidomos në shpërkë dhe mëlçi. Më vonë palca kockore dhe limfonodulat mbushen me makrofagë të infektuar dhe paralelisht zhvillohet leukopenia dhe anemia. Në mënyrë të ngjashme edhe veshkat mund të mbushen me makrofagë të infektuar. Shpërkë gradualisht zmadhohet duke arritur shpesh herë proporcione të mëdha. Infarktët splenike janë të zakonshme, kapsula trashet, sinuset dilatohen. Qelizat Kupffer të mëlçisë të mbushura me amastigotë bëhen edematoze dhe hiperplastike dhe shpesh vihet re nekrozë centrilobulare ose infiltrime dhjamore. Limfadenopatia, sidomos e gjëndrave mesenterike jep një numër të madh të makrofagëve të mbushur me parazitë dhe është një shenjë e hershme e sëmundjes. Palca kockore shpesh është e mbushur me histiocite me parazitë, të cilët zëvendësojnë elementët normalë të palcës dhe si rrjedhojë do të kemi anemi. Në përfundim duhet thënë se ndryshimet patologjike reflektojnë balancin midis shumëzimit të parazitit, ndryshimeve degjenerative dhe përgjigjes imune të pacientit.

## Manifestimet klinike.

Periudha e inkubacionit mund të variojë nga disa javë, deri në disa muaj. LV në mënyrë tipike infektin fëmijët nga 2-5 vjeç në mesdhe (L- infantum) dhe fëmijët më të mëdhenj dhe adultët në Afrikë dhe Azi. Pas inokulimit në lëkurë të parazitit nga mushkonja, fëmija mund të ketë një periudhë asimptomatike të infeksionit ose një periudhë me simptoma të pakta, e cila mund të zgjidhet në mënyrë spontane ose të zhvillohet një sëmundje aktive viscerele. Gjatë javëve të para ose muajve të evolucionit të sëmundjes, fëmija shfaq temperaturë intermitente, këputje, lodhje, anoreksi dhe shpërkë fillon të zmadhohet. Shenjat klasike të sëmundjes me temperaturë të lartë, shpërkë të zmadhuar, mëlçi të zmadhuar dhe limfadenopati zhvillohen 3-4 deri 5-6 muaj pas fillimit të sëmundjes, por forma akute, me klinikë të shpejtë e zhvilluar pas një muaji është parë te ndodhë në 20% të pacientëve. Në stadin terminal të leishmaniozes viscerele hepatosplenomegalia është masive, barku i madh, pancitopenia e thellë, ikteri, edemat dhe asciti mund të jenë prezente. Episodet e hemorragjive sidomos epistaksis janë frekvente. Stadet e vona të sëmundjes shpesh janë të komplikuar nga infeksione bakteriale sekondare të cilat shpesh përbëjnë shkaqet e vdekjes. Moshë e vogël sidomos 0-6 muaj, malnutricioni shërbejnë si faktor risku. Ndryshimet laboratorike përmbledhin :

- Gjaku komplet qe karakterizohet nga Pancitopeni (anemi, ulje e nivelit të hemoglobinës dhe numrit të eritrociteve, leukopeni, trombocitopeni)
- Limfocitozë
- ERS të rritur
- Hipergamaglobulinemia, nivele të larta të IgG dhe IgM, por sidomos të IgG-së, të cilat shkaktojnë një përmbysje të raportit albuminë/globulinë.

## **Diagnoza e LV**

Diagnoza definitive e LV-së vendoset nga demonstrimi i amastigotëve nga pjesëzat indore ose izolimi i organizmit në kulturë. Amastigotët mund të identifikohen nga seksionet indore të ngjyrosura me Giemsa ose aspiratet e marra nga shpretka, palca kockore, limfonodulat. Rezultatet nga lamat e ngjyrosura me Giemsa të para në mikroskop ose kulturat e vëna nga materialet e marra nga aspirati splenik, palca e kockave ose limfonodulat janë ato që vendosin diagnozën. Vendin e dytë për nga sensitiviteti si metodë diagnostike për LV pas aspiratit splenik që është 96-98% e zë aspirati i palcës kockore që vlerësohet të jetë në shifrat 65-68% dhe duhet theksuar se më shumë se 50% e rasteve riskojnë të mbeten të padiagnostikuara dhe të pa mjekuara n.q.s. nuk konfirmojmë diagnozën me metoda të tjera.

## **Serodiagnoza – immunodiagnoza**

Vlera e serologjisë për të vendosur diagnozën e LV-së është e madhe, sidomos në fazën akute të sëmundjes. Vlefshmeria e testeve serologjike varet nga teknika dhe pastertia e antigenit të përdorur.

**Testi Elisa:** (Enzyme linked immunosorbent assay). Ky test gjen përdorim për studime sero-epidemiologjike për shkak të ndjeshmërisë dhe specisifitetit të lartë që ka.

## **Testi i immunofluoreshencës Indirekte**

Reaksioni imunologjik vihet në dukje nga përdorimi i një globuline anti IgG e markuar me fluoreshencë. Testi konsiderohet pozitiv në rastet kur kemi fluoreshencë në hollimet më të mëdha se 1 me 160 të serumit që kontrollohet.

## **DAT-Hemaglutinimi direkt.**

Është test me sensitivitet dhe specisifitet të lartë, i lehtë për t'u kryer dhe rezultati merret brenda 24 orëve. Introduksioni i DAT-se në diagnozën e LV-së ka rritur kualitetin në deçizionet e mjekimit.

## **Western Blots (Hibridizimi ADN-ADN).**

Premton rezultate të shkëlqyera sensitiviteti dhe specisifiteti. Është e ndërlikuar si procedurë dhe kërkon laboratore kërkimore shkencore të specializuara.

## **PCR (Reaksioni i ndryshimit të polimerazës)**

Kjo metodë është zhvilluar duke përdorur fiksuesit specifike të leishmanias. Këto fiksues janë të drejtuar kundër një pjese të genit 18 SR RNA, i cili përmban sekuenca specifike të leishmanias. PCR është shumë sensitive në LV dhe jep rezultate të shpejta. Ajo ka treguar sensitivitet 90% dhe specisifitet 100% në përcaktimin e diagnozës së leishmaniozës viscerale.

Kombinimi i PCR me analizën restriktive izoenzimatiqe ka bërë të mundur diferencimin e specieve shkaktarë të leishmaniozës viscerale dhe asaj kutane.

### **Diagnoza diferenciale.**

Për formën akute duhet te bëhet me:

- Malarien
- Ethen tifoide
- Tifon abdominale
- Fazen akute të sëmundjes Kagasi
- Shistozomiazën akute
- Tuberkulozin miliar
- Abcesin amebik të shpretkës

### **Për formën subakute dhe kronike diagnoza diferenciale duhet te bëhet me:**

- Brucelozën
- Histoplazmozën
- Mononukleozën infektive
- Leukozat/limfomat
- Shistozomiazën hepatosplenike
- Baktereminë e zgjatur nga salmoneloza
- Splenomegalinë tropikale nga malaria kronike

### **Trajtimi**

Trajtimi specifik bëhet me kripërat e antimonit. Përbërësit pentavalent të antimonit që janë derivate të metalit të rëndë antimon (Sb) për herë të parë janë përdorur herët në vitin 1900 dhe vazhdojnë të jenë preparate të zgjedhur për leishmaniozën viscerale. Mekanizmi i veprimit të tyre akoma nuk njihet plotësisht, megjithatë ato duket se ndërhyjnë në inhibimin e parazitit.

- Sodium stibogluconate (Pentosam, Wellcome Foundation, Unitet Kindom) regjimi i rekomanduar është 20mg Sb/kg ne dite IV ose IM 1 here ne dite për 28 ditë.
- Meglumine antimoniate (glukantime, Rhafone – Poulenc France) regjimi i rekomanduar është 20mg Sb/kg ne dite IM 1 here ne dite për 28 ditë.
- Amfotericina B dezoksikolat dhe formulat e reja lipidike janë të suksesshme në trajtimin e formave të leishmaniozes viscerale, që nuk i përgjigjen mjekimit me kripërat e antimonit.
- Amfotericina B dezoksikolat në dozën 1mg/kg çdo ditë ose çdo dy ditë për 14-20 doza, ka një shkallë kuruese 100%.
- Amfotericina B liposomale 3mg/kg nga 1-5 ditë dhe përsëritje në ditën e 10-të ose 3mg/kg peshe nga dita 1-5-te dhe nje perseritje ne ditën e 14-te dhe ditën e 21-te ka treguar efikasitet të lartë për trajtimin e LV-së në fëmijët imunokopetentë, disa prej të cilëve kanë qenë refraktare ndaj kripërave të antimonit.

## **Alternativa te tjera Parenterale**

- Aminosidine (Aminozidina)

Njihet që në 1960, dhe më vonë i është provuar aktiviteti antileishmanial.

Aminoglikozidi injektabel, aminozidina, (identike me paromomicinën), është testuar për herë të parë e kombinuar me Sb në trajtimin e leishmaniozes viscerale në Kenia.

Përdorimi i këtij kombinimi kompeson efikasitetin e ulur të Sb dhe redukton kohëzgjatjen e terapisë.

Për këtë të fundit është provuar skema.

17 ditë Sb i.m (20 mg/kg/peshë/ditë) + Aminosidine (15mg/kg/ditë). Ky kombinim nuk duket te jete superior ne krahasim me kriperat e antimonit dhe Amfotericinen B. OBSH vazhdon ta provojë këtë agjent si mjekim të vetëm në Indi.

- Pentamidina 4mg/kg IV ose IM ne dite ose çdo 2 dite per 15-30 doza. Pentamidina per mjekimin e leishmaniozes viscerale kerkon doza te medha dhe kohezgjatje te terapise, duke e bere preparatin me pak te pelqyeshem se Amfotericina B dhe formulimet e saj lipidike.

## **Provat e Imunoterapisë me Citokina**

### **Interferon gama**

Këto tentativa kanë filluar duke parë potencialin makrofag aktivizues të tij, si dhe atë mbrojtës – induktues për infeksionet intraqelizore dhe në veçanti për Leishmaniozën.

Kombinimi i injeksioneve ditore të IFN- gama me Sb duket se japin një mbrojtje më të përforcuar. Por në një studim në Indi, ky kombinim krahas amplifikimit të mbrojtjes, rezultoi se kompromentoi shërimin “definitive”.

Megjithatë, kombinime të tilla për 14 ditë dhanë të njëjtat rezultate si dhe aplikimi 28 ditë i Sb. Kompromentimin e “shërimit definitive” në Indi e shpjegojnë me rezistencën ndaj Sb që ka kjo zonë endemike. Të sëmurët e mjekuar me kombinimin e mësipërm, efektivisht janë mjekuar vetëm me IFN-gama.

## **Amfotericina B**

Në 1900 konsiderohej si mjekim i parë për LV. Më pas kjo ide u abandonua, ndërsa sot ajo po provohet përsëri, jo vetëm si mjekim alternativ kur ka rezistencë ndaj Sb, por edhe si mjekim fillestar. Ajo ka dhënë shërim definitiv si në rezistencat ndaj Sb, ashtu edhe e përdorur që në fillim, në masën 95%. Por këto regjime janë tipikisht të zgjatura dhe jo mirë të toleruara. Një përqindje shërimi deri 99% ka dhënë përdorimi i dozave të plota (1mg/kg për 20 ditë, doza totale: 20 mg/kg). Regjimet më të fundit përfshijnë 15 infuzione 0,75 ose 1,0 mg/kg e dhënë një ditë po një ditë jo përgjatë një periudhe 30 ditore (doza totale 11-15 mg/kg).

## **Formulat Lipidike të Amfotericinës B; mjekimet me cikle të shkurtra**


Dispersionet në kolesterol të Amfotericinës B (Amphocil, Amphotec) janë të parat e aplikuara në kala-azar. Përdorimi i Amphotec 2 mg/kg/ditë për 7-10 ditë (doza totale 14-20 mg/kg) dhe përdorimi për 5 ditë (doza totale 10 mg/kg) ka dhënë shërim të plotë në respektivisht 100% dhe 90%.

Përdorimi i AmBisome ose i Abelect kanë demonstruar shërime në masën 90-100% duke përdorur doza suficiente totale (10-15 mg/kg për Abelect; 10-20 mg/kg për AmBisome, gjithmonë në varësi nga regjioni).

## **Ambisome dhe përdorimi i tij në LV**

- **Ambisome** është formulimi liposomal unik unilamelar i amfotericinës B dhe ka qenë i pari preparat liposomal intravenoz i vlefshëm nga ana komerciale.
- Në mjaft studime Ambisome ka treguar efektivitet në pacientet me sëmundje mykotike të rënda dhe të diseminuara si dhe ka qenë më i tolerueshëm se amfotericina B konvencionale.
- AmBisomi injektabel që përdoret për infuzionet intravenoze është një produkt steril, jo pirogjën dhe i liofilizuar.

Liposomet jane vezikula te mbyllura, sferike te formuara nga perzierja e porcioneve specifike te substancave amfofilike si fosfolipidet dhe kolesteroli, keshtu ato organizohen ne membrana koncentrike dyshtresore kur jane ne solucionet ujore/hidrofile. Me pas formohen liposomet e vecuara dyshtresore nga mikroemulsifikimi i vezikulave multilamelare. Ambisome perbehet nga keto liposome unilamelare dyshtresore me amfotericinen B te vendosur brenda membranës. Ambisome permban liposome me diameter me pak se 100 nm



- **Mekanizmi i veprimit**

- Amfotericina B eshte nje antibiotik antifungal makrociklik polien i prodhuar nga shtame te *Streptomyces nodosus*.
- Amfotericina B, perberesi aktiv i AmBisomit, vepron duke u lidhur me komponentin sterolitik te membranës qelizore, duke cuar ne alterim te permeabilitet qelizor dhe ne vdekje qelizore. Nderkohe qe amfotericina B ka nje afinitet te larte per ergosterolin, komponent i membranës qelizore fungale, ajo mund te lidhet gjithashtu me kolesterolin e qelizave te gjitareve duke dhene citotoksicitet.
- AmBisomi eshte aprovuar ne Evrope ne 1990, ku eshte tregtuar nga Gilead dhe NeXstar.
- Ne vitin 1997 u perligj perdorimi i AmBisomit ne SHBA, ku Gilead tregtoi preparatin ne bashkepunim me kompanine Fujisawa Healthcare.
- AmBisomi eshte i disponueshem ne me teper se 42 vende ne gjithe boten.

- **AmBisomi indikohet ne:**

Terapine empirike per infeksionet fungale tek pacientet febrile dhe neutropenike.

- Trajtimi i meningitit nga Cryptococcus ne pacientet e infektuar me HIV.
- Trajtimi i infeksioneve me shtamet Aspergillus, Candida, dhe/ose Cryptococcus refraktare ndaj amfotericin B deoxycholate, ne pacientet me crregullime te funksionit renal ose ne rastet ku toksiciteti i vrojtuar nga perdorimi i amfotericines B deoxycholate nuk lejon dhenien e saj.
- Trajtimi i leishmaniozes viscerale (Ne pacientet e imunokompromentuar dhe ata me imunitet normal)
- **Perdorimi i Ambisomit ne trajtimin e LV.**
- Eshte trajtim i zgjedhur tek femijet imunokompetente me LV, ose ne femijet qe nuk mund te tolerojne efektet anesore te terapise standarte.
- Rastet kur paraqitet rezistenca ndaj preparateve antimoniale (refraktare ndaj mjekimit si Glukantima, stiboglukonati i sodiumit)
- Rastet qe paraqesin relaps pas trajtimit te meparshem
- Koinfeksionet VL/HIV
- **C'eshte relapsi klinik**
- Studimet eksperimentale kane demonstruar qe pavaresisht nga trajtimi efektiv i LV, parazitit ngelet i heshtur ne organe te ndryshme.
- Nderkohe ky parazit mund te induktojte imunodepresion tek bujtasi, i cili ndiqet nga reaktivizimi dhe rishfaqja e manifestimeve klinike
- Nga ana tjetere, parazitet e leishmanias mund te zhvillojne rezistence ndaj preparateve antileishmaniale, si pasoje e nderprerjes se mjekimit apo dozave jo te pershtatshme mjekuese.
- Ne pacientet e infektuar me HIV, crregullimet e sistemit imun duket se kontribuojne ne fenomenin 'relaps'
- Me shume se 50% e pacienteve mund te zhvillojne relapsin 6 muaj pas trajtimit dhe 90% pas nje viti. Gjithsesi efikasiteti i perdorimit te preparatit ne rastet e koifektuara me HIV duhet te dallohet nga zhvillimi i rezistences antimoniale.
- Qe para 50 vjetesh, nga studimet e bera ishte e qarte se megjithese pacientet sheroheshin klinikisht dhe ne baze te kritereve parazitologjike, afersisht 20% prej tyre pesonin relaps 6-12 muaj pas terapise.
- Parashikimi se cili mjekim eshte i destinuar te jape relaps akoma nuk eshte i mundur.


- Disa evidenca sugjerojne qe deshtimi per te treguar nje renie thelbesore te antitropave anti K39 ose persistencen e ADN-se se parazitit me PCR(Polymerase Chain Reaction) te indeve te prekura, mund te jene shenja te nje risku per relaps pas trajtimit.
- Per kete arsye mendimet per relaps te mundshem cuan ne formulimin e dy koncepteve: 'i sheruar' ne aparence dhe 'i sheruar' perfundimisht (long term cure)
- I sheruar ne aparence, do te thote permiresim klinik, renie e temperatures, reduktimi i dukshem i hepari, lienit, evidence e sherimit parazitologjik
- ( negativizimi i mielogrames)
- Megenese mendohet se relapset ndodhin brenda harkut kohor 6 muaj deri ne 1 vit, atehere termi 'i sheruar definitiv' percakton statusin e te semurit kur ai kthehet ne shendet te plote, pa shenja ose simptoma sugjeruese te nje relapsi
- Ne mbledhjen e OBSH ne 1995, AmBisomi u perfshi ne rekomandimet e tyre si linje e pare e mjekimit te LV (3mg/kg/dite ne ditet 0, 1, 2, 3, 4 dhe ditet e 10 duke dhene nje doze totale 18mg/kg). (Gradoni et al)
- AmBisomi tregoi nje superioritet ndaj kriperave te antimonit pentavalent, persa l perket toksicitetit, lehtesise se administrimit dhe kohes se qendrimit ne spital.
- Pacientet imunokompetente, perfshire infantet dhe ata me relaps te meparshem, mund t'i aplikohen kurse te shkurtra trajtimi dhe diteqendrimi ne spital mund te jete deri ne 5 dite.



- **Vleresimi I pergjigjes se LV rezistente nga kriperat e antimonit, ndaj dozave te ndryshme te AmBisome**

	<b>Grupi A 0.75mg/kg/dite</b>	<b>Grupi B 1.5mg/kg/dite</b>	<b>GrupiC 3mg/kg/dite</b>
<b>Kurim</b>	<b>25(89%)</b>	<b>26(93%)</b>	<b>27(96%)</b>
<b>Deshtim</b>	<b>1(4%)</b>	<b>1(4%)</b>	<b>1(4%)</b>
<b>Relaps</b>	<b>2(7%)</b>	<b>1(4%)</b>	<b>0(0%)</b>

- Pas vitit 1990 dolen veshtiresi te reja ne menaxhimin e kala-azarit te cilat pasqyronin eksperienat e trajtimeve te semundjeve infektive ne gjithe boten.
- Zhvillimi I rezistences ndaj terapise konvencionale me Sb ne vendet ku semundja shfaqet me shpesh(Indi, Bangaldesh,Sudan) nderveprimi me virusin e HIV, dhe nje rritje te paparashikueshme ne deshtimin e trajtimit, kostoja e larte e medikamenteve te reja, jane tre veshtiresite me proeminente ne trajtimin e LV.



progresi i bërë që nga 1990 në zhvillimin e trajtimevetë reja për kala – azar.

Sb = antimon pentavalent; IFN  $\gamma$  = interferon gama;

\*Formulat lipidike të Amfotericinës B: kompleksi lipidik i Amfotericinës B (Abelcet); Amfotericina B lipozomale (AmBisome);

Dispersioni i amfotericinës B në kolesterol (Amphotec); emulsioni yndyror i Amfotericinës B.

### ▪ Epersite e mjekimit me Ambisome

- Toksiteti me I ulet ne raport me kriperat e antimonit
- E lehte per tu administruar ne raport me glukantimen
- Diteqendrimi ne spital me I shkurter
- Reduktimi I deshtimeve terapeutike ne rastet e kombinuara me infeksionin e HIV
- Shkalla e larte e sherimit ne rastet e rezistences nga preparatet e perdorura me pare.

### ▪ Veshtiresia e perdorimit te AmBisomit

- Kostoja e larte e preparatit
- Mjekimi me AmBisome I aprovuar nga FDA(U.S Food and Drug Administration) ne 1997 per pacientet e pacenuar imunologjikisht konsistoi ne 6 infuzione 3mg/kg ne dite, ne ditet 1-5 dhe ditet 10. Per femijen 25 kg kostoja 2068 \$.

### ▪ Vlerat klinike laboratorike qe duhet te kihen kujdes:

- Nefrotoksiteti percaktohet si rritje e vlerave te kreatinines 100% ose me teper ne krahasim me vlerat e para trajtimit ne pacientet pediatrike.
- Hipokalemia percaktohet nga nivelet e kaliumit  $\leq 2.5$  mmol/L ne cdo kohe gjate trajtimit

- Infuzioni duhet te pergatitet sipas rregullit te indikuar ne menyren e pergatitjes dhe duhet te behet per 1-2 ore me shiringe elektrike
- Pacientet e trajtuar me ambizom kane nje incidence me te ulet te reaksioneve te lidhura me infuzionin si: ethe, kolle dhe te vjella ne krahasim me paciente qe kane perdorur Amfotericin B deoxycoholate.

### **Protokolli mjekimit**

- Ambisomi arrin shkalle te larte te klerances te parazitit ne pacientet imunokompetente kur administrohen doza totale nga 12 deri 30 mg/kg peshe.
- Dozat e rekomanduara per trajtim te LV ne pacientet imunokompetente jane 3mg/kg/dite nga 1-5-te dhe ditën e 10 (6 doza ) ose 3mg/kg /dite nga dita 1-5 dhe ditën e 17 dhe 21 (7 doza).
- Dozat e rekomanduara te ambizomit per trajtim te LV ne pacientet e imunokompromentuar jane 4mg/kg/dite (totali 40mg) ne ditet 1-5 dhe ditet 10,17,24,31,38. Kur kleranca e parazitit nuk eshte arritur te te semuret ose kur te semuret zhvillojne relaps trajtimi eshte me i zgjatur .

**Chemotherapy and trends in leishmaniasis  
WHO-EURO Program Managers Meeting on Leishmaniasis Control,  
Istanbul, 17-19 November 2009**

**Leishmanioza Viscerale  
(current first line regimen)**

- Europa: ambisome 3-5 mg/kg/dite per 3-10 dite, ose forma te tjera lipidike te amphotericines B (Amphotec, Amphocil)
- Amerika e Jugut dhe Qendrore: antimonialet
- Indi: antimonialet, amphotercine B, miltefosine.
- Rajoni i Lindjes se mesme: antimonialet

### **Antimonialet (sodium stibogluconate/meglumine antimoniate)**

- Trajtimi : 20 mg/kg/dite per 28-30 dite
- Terapi e perdorur qe prej 70 vjetesh
- Efektivitet te larte pervec Indise dhe Nepalit
- Kosto e perballueshme.
- Dizavantazhet : toksiciteti, injeksione te dhimbshme dhe zgjatje e kohes se terapise

### **Amfotericina B (per LV)**

- Trajtimi: 1mg/kg/dite per 15 dite
- Forma konvencionale ka efektivitet dhe kosto te perballueshme, por kerkon monitorim intraspitalor per shkak te toksicitetit
- Format lipidike jane zgjedhja e pare per trajtimin LV nder te cilat ambisome eshte me efektshem, bariere eshte kostoja (Ambisome ®).
- Forma te tjera lipidike afersisht

5-10 here cmimi me i lire se ambisome.

- **Paromomycin** : trajtimi 15 mg/kg per 21 dite
- Efektivitet te larte ne Indi, variabel ne Afrike. I licensuar vetem ne Indi
- **Miltefosina**: trajtimi 1.5-2.5 mg/kg per os per 28 dite, i vetmi preparat oral per trajtimin e LV( perdorim i limituar, ne femije mbi 12 vjec per shkak te teratogjenicitetit).

### **Terapi e kombinuar (skemat ne studim)**

- Indi (finished 2010 in India)
- Ambisome 5mg/kg +7 dite MF
- Ambisome 5mg/kg + 10 dite PM

- MF + PM per 10 dite
- Afrika Perendimore (multi-center finished 2014) SSG + PM/17 dite
- Ambisome 10mg /kg + 10 dite MF
- Ambisome 10mg/kg + 10 dite SSG

### **Trajtimi i rasteve me rezistence nga kriperat e antimonit**

#### ***NJE RAST ME LEISHMANIOZE REZISTENTE E MJEKUAR ME AMBISOME DHE E KOMPLIKUAR ME MYOKARDIT DHE PLEUROPNEUMONI***

***DHJETOR 2009***

#### **Shtrimi i pare**

- Emri : Naxhie
- Mbiemri : Troci
- Mosha : 4 vjec
- Vendbanimi : Rec- Peshkopi
- Pesha : 12 kg
- Diagnoza e shtrimit te I: Date 28/8/2006  
Suspekt Leshmania
- Histori e semundjes
- Femija kishte rreth 1 muaj me temperature deri ne 38-39°C, keputje, djerse, anorexi, dhimbje barku, te vjella.

- Lindur nga nje barre normale, pesha e lindjes 3200g, ushqyer me gji deri ne 7 muajsh, vaksinuar rregullisht, ka kaluar varicelen ne moshen 2 vjec te komplikuar nga nje bronchopneumoni, shtruar ne spitalin e Peshkopise, gjendja e femijes deri ne 1 muaj para paraqitjes ne spital e mire.
- Anamneza familjare: Asgje me rendesi.
- Anamneza morbi: Femija kishte rreth 3 jave me temperature here pas here, kishte filluar te zbehej, kishte djerse, anoreksi dhe here pas here dhimbje bark; vizitohet ambulatorisht dhe mjekohet me Amoxyciline + Gentamicine, gjendja e papermirsuar, shtrohet per determinim diagnoze.
- Diagnoza: Suspekt Leshmania
- Ekzaminimi Objektiv:

Gjendja ne hyrje, jo e mire e keputur, e lodhur, temperature 38°C, qafa e lire, pa shenja meningeale, lekura e zbehte, frymemarrja e qete. Ne pulmone respiracioni i ashper, zemra me tone te qarta ritmike, FR=86min, barku i bute, hepari preket 2-3cm, lieni 4cm.

- Indekset laboratorike:

E=3.940.000 L=7400 Hg=8.29g/dl Sed=40  
 Trombocitet=82.000 limfocitet=68% garnulocitet=21% monocitet=40.2 urea=19.2mg/dl  
 kreatinina=0.41mg/dl ALP=68U/l AST=21U/l BT=95mg/dl Na+=129mmol/l  
 K+=4.6mmol/l

Urine komplet: Normal

- Echo abdominale:
- Hepar i zmadhuar 126mm. Lieni i zmadhuar 133mm
- Radiografi pulmoni – Pulmon negativ
- Mielograma: Leshmania pozitive ne grupe
- Fillohet Glukantime 3cc I.M dhe mjekohet per per 2 jave, Mjekimi eshte toleruar mire, femija gjate qendrimit ka perdorur perfuzione dhe vitaminoterapi.
- Femija del date 14/9/2006 per te vazhduar ciklin e dyte te mjekimit pas 2 javesh. Gjendja ne dalje e permirsuar, hepatosplenomegali e reduktuar, pa temperature, indekse laboratorike me te permirsuara.
- Femija ka vazhduar ciklin e dyte te mjekimit ne spitalin e rrethit 13 dite me Glukantime, gjendja eshte permirsuar por per pamundesesi kushtesh femija nuk ka ardhur per kontroll pas mbarimit te mjekimit, gjendja ka qene me e mire deri ne fillim te nentorit, ku femija paraqitet ne Tirane 2/11/2006 me diagnoze ne hyrje: Bronchopneumoni sinistra, gjendje post Leshmanie.
- Ne shtrimin e dyte: Gjendja e femijes ne hyrje jo e mire, temperature e larte deri ne 40 grade, kolle, e lodhur e zbehte, sipas prindit femija kishte rreth 5 dite me keto ankesa. Ne ekzaminimin objektiv femija paraqet: nje lekure te zbehte, te thate,

- frymemarrja e qete, Ne auskulatacion degjohen rale krepitante dhe bronchiale, zemra tonet e qarta, ritmike. Paraqet hepatosplenomegali. Hepari 4cm; lieni 3 cm me konsistence te forte.
- Radiografi pulmoni: pneumoni lobare sinistra
- Date 07.11.2006 aplikohet Mielograma per te perjashtuar Leishmanian dhe rezulton Leishmania negativ.
- Femija ka vazhduar ne gjendje jo te mire, grafikisht me bronkopneumoni dekster dhe pneumoni sinistra, dhe me dt. 17.12.2006 gjendja e femijes eshte renduar mjaft me kolle spazmodike, dispne, terheqje epigastrike dhe ne auskultacion degjohet ritem galopi.
- Echo e zemres rezulton: VM ne kufijte e siperm te normes por me fluks sistolik te ulur (tkurrje jo te mira). DTD=33.6mm, DTS=26.4mm FS=21% AO/AM=14mm/25mm. Nuk shihen defekte septale. Fluksi mitral, aortik, Pulmonar, Trikuspidal normal, pa regurgitacion mitral, VD lehtesisht i dilatuar 16.8mm. Perikardi i thate pa likid.
- EKG: takikardi sinusale, cregullime te repolarizimit, sheshim i ST.
- Konkluzion: Nga te dhenat klinike dhe ekokardiografike mendojme per interesim te miokardit dhe miokardit acut. Femija transferohet ne reanimacion ku ka filluar mjekim me:

Digoxine tb., Enalapril dhe Lasix (per os). Ne reanimacion femija eshte mbeshtetur me dopamine i.v. O2, dhe eshte monitoruar per Fk, Fr, dhe TA, ka vazhduar mjekimin ne pneumologji, ku eshte kryer dhe fibroskopia (dt.04.12.2006) e cila ka rezultuar : majtas bronku i majte i lire, bronku lingual me mukoze hiperemike edematoze dhe sekrecione mukopurulente. Gjithashtu edhe bronku i djathte me sekrecione purulente Femija gjate qendrimit ne reanimacion dhe pneumologji eshte mjekuar me Rocefine, Amikacine, Ceftazidine, dhe Eritromicine dhe ne dt. 20.12.2006, gjendja e femijes eshte permiresuar dhe ne konsulte me kardiopediatrin vendoset qe ne kuadrin e miokarditit te vazhdoje mjekimin me tonikokardiak, diuretike dhe vazodilatator, nen efektin e te cilave vihet re nje permiresim klinik dhe mbeten per t'u vleresuar te dhena ekografike te cilat mbeten ende te alteruara.

- Vazhdon mjekim ambulatorisht me digoxine, enalapril dhe lasix. Rikontroll pas 3 javesh.
- Date 12/4/2007 Femija paraqitet per nje shtrim te trete ne spital.
- Diagnoza e hyrjes: Bronchopneumoni bilaterale, gjendje post Leshmania ne Pneumologji. Gjendja e femijes sipas prindit 1 jave perpara paraqitjes ne spital ka qene e mire, 5 ditet e fundit femija me temperature te larte 39-40°C, keputje zbehje, anorexi, dhimbje barku, kolle me sekrecione. Ne ekzaminimin objektiv femija paraqitet mjaft i lodhur, i zbehte, degjoheshin rale bronchiale dhe krepitacione.
- Ne auskultacionin e zemres zhurme sistolike ne apex dhe terheqje subkostale. Barku i madh mbi nivelin e thoraxit, me vizatim te theksuar venoz kolateral. Hepari 4-5cm, Lieni i zmadhuar deri ne kristen iliake.

- Ekzaminimet e bera: Echo e zemres: tkurrjet e zemres me te ulura, VM i dilatuar, DTD 39.5mm dhe DTS 30mm, FS 21%. Aorta me hapje te mire, fluks normal, AM 29mm, AO 15mm. Minimal regurgitacion trikuspidal, pa likid ne perikard.
- Konkluzion: kardiomiopati e dilatuar me performance te ulur ventrikulare me bronchopneumoni bazale sinister.
- Femija nga sherbimi i pneumologjise transferohet ne kardiologji ku dhe ndiqet me diagnoze: Kardiomiopati e dilatuar, Bronchopneumoni bilaterale.
- Sugjerohet ne konsulte me infeksionistin nje mielogramme pasi hidhet ideja e nje relapsi klinik te Leishmaniozes.
- Mielograma : Pozitiv per Leshmania.
- Femija paraqitet me anemi ne gjakun periferik:

E=2820000      L=3100      Tr=188000      Sed=40      Hg=6.1g/dl  
 Limf=71.8%      Mono=9.3%      Gra=18.9%  
 ▪ Analizat Bio-Kimike: glicemia=93mg/dl      K+=3.8mmol/l      Na+ =129mmol/l  
 AST=37U/l

ALT=64U/l      kreatina=95mg/dl      TB=05mg/dl

Proteinograma e plote:      Albumina 33.1%  
 alfa1globulina=4.2%      alfa2globulina=8.7%  
 betaglobulina=5.8%      gamaglobulina=48.3%

- Ne keto kushte femija paraqet nje bronchopneumoni bilaterale me insuficienc respiratore dhe kardiomiopati e dilatuar pas nje miokarditi dhe LV forme rezistente.
- Femija gjate kesaj kohe eshte trajtuar me Digoxin I.V me pas eshte kthyer per os dhe Enalapril per os dhe lasix. Gjithashtu mjekuar me Ceftazidine+ Amikacine per Bronchopneumonine; femija eshte monitoruar me ndjekje te FK, FR dhe Sat e O2, pasi gjendja e femijes ka qene e rende dhe ne konsulten e perbashket eshte konkluduar per nje prognoze te rezervuar.
- Ne keto kushte eshte vendosur qe femija per mjekimin e LV te marre Amphotericine B(ambisome), deri ne sigurimin e mjekimit femija ka bere 2 here transfuzione gjaku, eshte mbeshtetur gjithe kohen me mjekimin e miokardipatise, eshte ndjekur niveli i elektroliteve ne gjak, duke ruajtur vlerat optimale te kaliumit, eshte ndjekur diureza dhe eshte monitoruar.
- Date 3/5/2007 femija eshte transferuar ne sherbimin e infektivit, ku gjendja ka qene me e permirsuar dhe femija ka vazhduar mjekimin mbeshtetur per miokardiopatine (enap, lasix, per os).
- Kontrollohet me Echo kardiake cdo 5-6 dite dhe reperti perseri ka treguar nje ventrikul te majte te dilatuar, me tkurrje me te dobesuara. DTD=38.8mm, PTS=29mm, FS=25%. Radiografi pulmoni ka treguar nje permirsim te repertit



- radiologjik duke pershkruar nje theksim hiliar bilateral.Treguesit e gjakut periferik jane me te permirsuar, dhe niveli i elektroliteve ne gjak normal.
- Perpara fillimit te mjekimit me Ambisome femija ka kryer testin serologjik per te perjashtuar infeksionin e HIV, i cili ka rezultuar negativ.
- Date 28/5/2007 femija ka filluar dozen e I-re me 3mg/kg peshe (pesha 13kg) ( 39mg). Protokolli i perdorur ka qene 7 doza dita 1-5 doza e 6 diten e 14 dhe doza e 7 diten e 21. Gjate gjithë kohes se marrjes se mjekimit femijes i eshte monitoruar niveli i kreatinines dhe urea, niveli i K+, Na+, dhe ALT eshte ndjekur per fenomene alergjike apo reaksione te lidhura me infuzionin si temperature, kolle, urtikarie etj. Femija e ka toleruar mjaft mire mjekimin.
- Indekset laboratorike normale pas mjekimit
- Mielograma e aplikuar pas mbarimit te mjekimit: Negativ per Leshmania
- Hepatosplenomegalia me e reduktuar pas mjekimit, por jo ne kufijte e normes
- Ne Echokardiografine perpara daljes femija paraqet perseri VM te dilatuar me tkurrje me te ulura, DTD=39mm, DTS=88mm, FS=25-26%, atriumi i majte lehtesisht i dilatuar. AO/AM=15.4mm/27mm. Flukset valvulare normale, pa likid ne perikard, te vazhdoje mjekim ambulatorisht me (digoxine,lasix,enalapril), rikontroll pas 3 muajsh.
- Femija eshte rikontrolluar pas 3 javesh, dhe pas 1 muaji. Klinikisht ka qene ne gjendje te mire, pa temperature dhe hepari e lieni te reduktuar dhe indekse laboratorike mjaft te permirsuara.

Me tej eshte ndjekur nga sherbimi i kardiologjise ku ekzaminimi echokardiografik ka treguar kardiomiopati drejt permirsimit me FS 28%. Aktualisht femija ne gjendje te mire

## Monitorimi-Rekomandime

### Gjate trajtimit:

Gjate trajtimit te pacientit me kriperat e antimunit behet vleresimi klinik cdo dite.EKG nje here ne jave dhe ne rast rreziku te rritur per kardiotoksicitet cdo 2-3 dite,transaminazat,funksioni rena ldhe amilaza/lipaza behen nje here ne jave ose sipas rastit dhe me shpesh.

Amfotericina B: funksioni renal dhe kalemia testohen dy here ne jave.

Miltefosine and paromomycin:funksioni renal dhe hepatic kontrollohen cdo jave.

### Pas trajtimit:

- Duhet bere vleresim klinik,gjak komplet dhe duhet kontrolluar pacienti nrm (PCR),reaksionit te ndryshimit te polimerazes,i cili eshte nje indikator shume I rendesishem ne rastet e relapsit klinik,ne muajt 0, 1, 3 dhe 6.

- Tek personat me imunosupresion duhet bere ndjekje e vazhdueshme gjate 6 muajve.
- Ekzaminimi mikroskopik i asprateve indore behet vetem ne rast mospergjigjeje ndaj trajtimit ose ne relaps.
- Terapia mbajtese te personat e imunodeprimuar nderpritet vetem nese gjendja klinike eshte stabel dhe niveli i CD4 qendron mbi 200/mikroliter per me teper se 6 muaj.

### Instruktimi i pacientit-Rekomandime

Gjate trajtimit, pacienti duhet ti raportoje mjekut nese i shfaqet nje nga gjendjet e meposhtme:

- Palpitacione
- Mbajtje te frymemarrjes
- Dhimbje abdominale
- Te vjella
- Cdo simptome e re

Pas trajtimit pacienti duhet te konsultohet tek mjeku nese ka:

- Ethe
- Simptoma te tjera te ngjashme me episodin e pare

Ne mars te 1995, ne Londer, nga London School of Tropical Medicine, u be nje studim mbi kontrollin e leishmaniozes viscerale.

Studimi u organizua dhe u financua nga qeveria angleze, Organizata Boterore e Shendetesise, Shoqata Panamerikane e Shendetesise dhe me mbeshtetjen e Komisionit European dhe Qendres Nderkombetare te Zhvillimit e Kerkimeve (Kanada)

# **1: LV dhe kujdesi paresor**

## **1.1 Cilat jane shenjat e mundshme te LV ?**

Shenjat kryesore jane splenomegalia dhe nje ethe e zgjatur. Shenja te tjera jane renie ne peshe, zbehje, zmadhim i heparit, zmadhim i limfonodujve, kolla dhe diarreja. Keto simptoma mund te imitojne shenjat e malaries, tifos, tuberkulozit, shistozomiazes, malnutricionit, histoplazmozes etj. Persa i perket moshave me te prekura nga LV, eshte pare qe ne Amerike dhe ne Mesdhe( me perjashtim te Europes jugore) preken me shpesh infantet sesa femijet me te rritur. Ndersa ne regjionin e Europes jugore moshja me e prekur eshte femijet 2-5 vjec.

Ne zonat endemike te malarias, kala-azar duhet dyshuar kur ethja zgjat dy ose me shume jave megjithe trajtimin me antimalarike.

## **1.2 Cfare masash duhen marre tek pacientet qe dyshohen per LV ?**

Duhet pasur parasysh anamneza dhe arsyet pse duhet dyshuar LV. Hapi tjetër varet nga mundesite qe te ofron struktura shendetesore. Ne qofte se nuk ka mundesi per te konfirmuar dyshimin klinik, atehere pa vonese i referohemi pacientit dhe shembujve te pacienteve te tjere ne qofte se ka.( shih 2.6 dhe 2.7).

## **1.3 Cilet jane treguesit qe te orientojne per pranine e insekteve sandfli ?**

Pyeten njerezit e zones nga vjen pacienti nese jane pickuar nga ndonje insekt, qofte gjate ekspozimit ne diell, qofte gjate nates. Pyeten se si e quajne ata kete insekt. Ne disa zona keto insekte njihen per pickime serioze, ne periudha te vecanta te vitit. Me kalimin e kohes sandflies mund te gjenden dhe ne ambientetet brenda shtepive, ne oret e para te mbremjes. Keto insekte duhet te kapen dhe te izolohen per identifikim te mevonshem.

## **1.4 Cilat jane masat qe duhen marre per te reduktuar pickimet nga sandflieset ?**

Perpjekjet duhet te behen ne drejtim te uljes se numrit te ketyre insekteve duke veshur rroba te pastra dhe nese eshte e mundur te flihet me mbulesa me mbrojtese ndaj mushkonjave ose te bera me insekticide te pershtatshme. Nese dihet se ka njerez ne shtepi qe po pickohen nga insektet, duhen lyer muret e shtepise me insekticid. Duke pasur parasysh qe disa specie te sandflies vendosen ne materiale organike qofshin keto brenda apo jashte shtepise, atehere nje pastrim i territorit perreth mund te jete efektiv.

## **1.5 Cilet jane mjetet dhe sherbimet minimale dhe speciale qe kerkohen ?**

1.5.1 Duhet te jete detyrim ligjor shpallja e te gjithë rasteve me Leishmania.

1.5.2 Duhet dokumentuar sipas formave standarte te gjithë rastet e dyshuar apo te provuar te LV.

1.5.3 Nese nuk ekziston nje harte e shperndarjes lokale atehere duhet pregatitur nje e tille ku te tregohen te gjitha shtepite dhe rruget qe kane lidhje me to. Keto harta duhet te krijohen ne menyre te tille qe te vlejne per studimet epidemiologjike dhe planifikimin e nderhyrjeve te mundshme.

## 2: LV dhe mjeku

### 2.1 Cfare karakteristika jane perdorur per te bere diagnozen diferenciale ?

Si shembull jane marre karakteristikat klinike te dokumentuara tek pacientet me LV ne Sudan, Brazil dhe Indi.

	<b>Sudan</b>	<b>Brazil</b>	<b>Indi</b>
<b>Ethe</b>	95%	95%	99%
<b>Splenomegali</b>	95%	99%	98%
<b>Renie peshe</b>	80%	98%	87%
<b>Anemi</b>	75%	98%	96%
<b>Zmadhim te limfonodujve</b>	75%	30%	90%
<b>Humbje te oreksit</b>	70%	20%	30%
<b>Kolle</b>	75%	40%	50%
<b>Hepatomegali</b>	60%	90%	98%
<b>Epistaksis</b>	50%	30%	10%
<b>Diarre</b>	40%	60%	50%
<b>Te vjella</b>	15%	te ralla	te ralla
<b>Ikter</b>	5%	10%	
<b>Edema</b>	5%	40%	

Keto shenja jane me te shpeshtat ne te gjitha vendet endemike, por disa prej tyre si per shembull zmadhimi i limfonodujve jane me te shpeshta ne Sudan dhe Indi.

Zakonisht periudha e inkubacionit eshte 2-6 muaj, por mund te jete dhe me e gjate apo me e shkurter. Fillimi mund te jete gradual ose akut.

Ne vendet endemike per malarien prezantimi klinik i LV mund te jete i ngjashem me ate te malaries. Pacienti konsiderohet me LV kur ka nje ethe te zgjatur, te shoqeruar me shenja te tjera, qe nuk i pergjigjet trajtimit me antimalarike dhe kur ne ekzaminimet e perseritura te gjakut nuk jane gjetur parazite te malaries.

Ne te gjitha vendet diagnoza diferenciale duhet bere me tifon,tuberkulozin, SIDA-n, brucelozen, hepatitin kronik, cirrozen, limfomat dhe leucemite. Splenomegalia mund te jete karakteristike e LV, hipertensionit portal (ne cirroze e shistozomiaze), dhe e malaries.

Per te konfirmuar diagnozen jane te rendesishme testet laboratorike tek te cilat zbulohet leukopeni (85% e pacienteve ne Sudan), trombocitopenia (75% e pacienteve ne Sudan) dhe prania e antitropave ne serum (95% e pacienteve qe nuk kane AIDS). (shiko pjesen 3)

## **2.2 Cilat jane prezantimet klinike atipike?**

Nje prezantim klinik atipik mund te jete pa splenomegali, por me ethe, lodhje, diarre, kolle ose kombinimin e tyre. Ne perendim te Bengalit ne Indi eshte raportuar paraqitje klinike me prekje te gjeneralizuar te limfonodujve pa prekje viscerale.

